

NJË PËR TË GJITHË



TË GJITHË PËR NJË

DEMOKRACI DHE JO DISKRIMINIM

VALDRIN (13), ELTON (14), LEON (13), DIKLEA (13), INTI (13), ARIONA (13), ERA (13)



Në demokraci të drejtat tona janë të barabarta dhe shumë të rëndësishme

Demokracia është sistem ku të gjithë jemi të barabartë. Demokracia gjithashtu është formë e udhëheqjes së shtetit, ku udhëheq vet populli. Por, si udhëheq populli? Ne e dijmë se ju lexues të këtij artikulli, keni dëgjuar për votat dhe procesin zgjedhor. E pikërisht me anë të votës, populli udhëheq në demokraci.

Në procesin zgjedhor populli zgjedh përfaqësuesit e vet. Këta përfaqësues janë personat që qeverisin vendin. Kjo nënkupton se, nëse populli nuk do t'i votonte kandidatët e ndryshëm, ata nuk do të bëheshin udhëheqës të vendit.

Demokracia është e ndërtuar dhe funksionon në bazë të disa elementeve siç janë: toleranca, solidariteti, paqja, liria, barazia etj.

Demokracia ndahet në dy grupe kryesore, e ato janë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë.

Demokracia përfaqësuese është kur populli i zgjedh me anë të votës, udhëheqësit e vet. Kurse, në atë të drejtpërdrejtë, populli i merr vendimet në mënyrë direkte. Mirëpo, edhe demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme kryesore: sistemin parlamentar dhe presidencial. Demokracia përfaqësuese me sistem parlamentar praktikohet në vendin tonë. Kjo do të thotë se ne nuk e votojmë drejtpërdrejtë Presidentin por atë e zgjedhin deputetët. Për ta kuptuar demokracinë më mirë e marrim një shembull konkret nga jeta jonë.

Shkolla jonë „Zenel Hajdini“ ka marrë një iniciativë për të ndihmuar „SOS Fshatin“ vend ky ku jetojnë fëmijët e braktisur. „SOS Fshati“ është një vend i ndijshëm, ku fëmijët që jetojnë aty kanë nevojë për ndihmën tonë. Prandaj, ne kemi ndihmuar aq sa kemi pasur mundësi. Jemi organizuar dhe kemi mbledhur: të holla, libra, lodra dhe rroba të ndryshme. Këto të holla i kemi mbledhur me përgatitjen e ushqimeve, e këto ushqime i kemi shitur brenda shkollës.

Ne gjithashtu jemi fëmijë por e kuptojmë dhe mund ta marrim me mend se çfarë është të jesh i vetëm në këtë botë. Ne kemi filluar të mendojmë për jetën e tyre dhe kemi dashur që t'ua ofrojmë ndihmën tonë.

Prandaj, ne mendojmë se duhet të jemi më të vetëdijshëm për jetën tonë të cilën dikush e ka ëndërr ta ketë si ne. Pa marrë parasysh racën, gjiinë, fenë, kombin apo gjendjen ekonomike, ne duhet të jemi demokrat. Kjo është porosia e grupit tonë për të gjithë ju.



Gazetarët e këtij artikulli

NJË ARDHMËRI E NDRITUR

ADONIS (13), EDION (13), ART (13), ARZANA (13), ALTINA (13), AULONA (14)

Ne në artikullin tonë kemi shprehur si është të jetosh në një vend demokrat dhe se si populli zgjedh përfaqësuesit e vendit

Siç e dijmë ne, me fjalën demokraci kuptojmë një liri ndaj të gjithëve, pa marrë parasysh se a kemi fe apo racë të ndryshme. Të gjithë ata që e kanë dashur këtë liri, kjo dëshirë u është realizuar me zbulimin e demokracisë. Kjo ëndërr më herët ka qenë vetëm një dëshirë e pa realizuar. Tani ne të gjithë e përjetojmë këtë liri, që është një gëzim i madh sikur të na dhuronin botën. Ne pos kësaj kemi edhe përfaqësuesit e vendit tonë. Ku ne me zgjedhjet tona lejojmë që ata të ndërtojnë një ardhmëri më të mirë për vendin tonë. Nuk duhet harruar se ne do jemi ata që do e çojmë përpara vendin tonë në të ardhmën. Ne më së miri e dijmë se çfarë është e mirë për popullin tonë, sepse çdo ditë e më shumë duam që të shkojmë përpara.

Kështu ne sadopak me fjalët tona e kemi shprehur fjalën demokraci dhe dashurinë për një ardhmëri me të ndritur për vendin tonë.



Autorët e artikullit




Një deputete duke folur për një çështje të rëndësishme parlamentare.



Demosi (populli) është i lirë të zgjedh përfaqësuesit e vet me anë të votave



Një botë me shumë ndryshime të mira



Vota jote bën ndryshimin

UNË DHE PUSHTETI

EDONIS (14), SAMIRE (13), LORJAN (14), VALMIR (13), MEDINA (13), DJELLZA (14)



Ne jemi nxënësit e shkollës „Zenel Hajdini“ dhe do të flasim për ndarjen e pushtetit. Lexojeni artikullin tonë që të merrni më shumë informacione për këtë temë

Njeriu rritet me tingujt e përditshëm dhe mëson si t'i bëj njerëzit afër vetes të dashur. Kjo është ajo e cila na karakterizon ne dhe ciklin tonë të jetës. Në vitrinat më të mëdha të bibliotekave botërore ka libra për demokracinë. Mirëpo, ç'është demokracia për ne? Për

ashtu edhe me veten.

Pushteti në Kosovë ndahet në tri degë. Ato janë dega legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Si institucion legjislativ është Kuvendi i Kosovës. Ai i shkruan dhe miraton ligjet tona. Qytetarët e Kosovës zgjedhin deputetët e Kuvendit dhe udhëheqësit e vendit tonë me anë të votave. Kuvendi është i përbërë nga 120 deputetë dhe secili prej tyre ka detyra të caktuara. Qeveria është institucion ekzekutiv i cili i zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi. Qeveria dhe Kuvendi bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për zgjidhjen e problemeve në vendin tonë. Si institucion gjyqësor kemi gjykatat të cilat ndajnë drejtësi. Ne në Kosovë e kemi Gjykatën Themelore, të Apelit dhe atë Supreme. Ndërsa Gjykatat Kushtetuese merret me interpretimin e Kushtetutës së Kosovës dhe neneve të saj. Secili nga këto institucione ka detyra të ndara por ato punojnë së bashku me njëra-tjetrën. Kjo ndodh edhe në një orkestër, ku të gjitha instrumentet luajnë së bashku që të krijojnë muzikën që ata dëshirojnë të bëjnë.




Grupi që punoi këtë artikull

ne demokracia ka vlerë të madhe. Për ne, demokracia nuk do të thotë se është Kryeministri, Presidenti apo ministrat ata që udhëheqin, por jemi ne ata që e udhëheqim vendin tonë. Ne mendojmë se duhet qeverisur me vëmendje të madhe ndaj zërit të popullit, sepse populli iu ka besuar përfaqësuesve të vet. Ky besim i madh nuk duhet humbur sepse nëse ne bëjmë padrejtësi, atëherë jemi të padrejtë si me popullin



Ndarja e pushtetit e paraqitur në vizatim



Ne punojmë që demokracia të zhvillohet gjithmonë



Jetojmë të lumtur dhe pa bregë me elementet demokratike



Të bashkuar ne shkojmë përpara. Ta ndihmojmë njëri - tjetrin sepse të gjithë jemi të barabartë



Ndarja e pushtetit e paraqitur në vizatim



Ndarja e pushtetit e paraqitur në vizatim



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Zenel Hajdini“
Klasa: VIII-5
Vendi: Prishtinë